



ILD

INSPEKTORI I LARTË
I DREJTËSISË



Nr. Prot. 373

Dt: 30.09.2021

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

ndërmjet

Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë

dhe

Inspektoriatit të Këshillit të Lartë Gjyqësor të Republikës së Bullgarisë

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani dhe Inspektoriatit të Këshillit të Lartë Gjyqësor të Republikës së Bullgarisë përfaqësuar nga Inspektori i Lartë znj. Toedora Tochkova, në vijim referuar si “pjesëmarrësit”,

- Me dëshirën për të përmirësuar bashkëpunimin dypalësh në shkëmbimin e praktikave për hetimin e shkeljeve disiplinore dhe inspektimeve dhe në çështjet e interesit të përbashkët;
- Në respekt të misionit dhe parimeve që udhëheqin veprimtarinë e secilit pjesëmarrës;
- Duke marrë në konsideratë se në fushën e marrëdhënieve reciproke ekziston një interes i përbashkët, për garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, garantimit të pavarësisë së sistemit të drejtësisë, garantimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si dhe mbrojtjen e interesit publik;

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi

Brenda kuadrit të juridiksionit të tyre dhe në përputhje me legjislacionet përkatëse, pjesëmarrësit do të fuqizojnë marrëdhëniet ndërinstitucionale dhe do të shkëmbejnë praktikat më të mira, në kuadër të procedurave të verifikimit të ankesave, hetimit të shkeljeve disiplinore, fillimit të procedurës disiplinore ndaj magistratëve si dhe të realizimit të inspektimeve institucionale e tematike.

Neni 2

Objektivat

Për zbatimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi, pjesëmarrësit do të bashkëpunojnë si më poshtë:

- Duke shkëmbyer praktika dhe përvoja që lidhen me hetimin disiplinor të magjistratëve, si dhe inspektimet institucionale dhe tematike;
- Duke shkëmbyer informacione për sistemin ligjor dhe legjislacionin në fushën e procedurave disiplinore ndaj magjistratëve, si dhe aktivitetet legjislativ të rëndësishme për zbatimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi, masat e zbatimit të ligjit në fushat e juridiksionit të tyre dhe eksperiencën e tyre ndërkombëtare;
- Duke dhënë këshillim mbi praktikat dhe standardet më të mira ndërkombëtare të zbatueshme gjatë procedurës së hetimit disiplinor, përfshirë jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- Duke shkëmbyer përvoja mbi metodologjinë e kryerjes së inspektimeve tematike dhe institucionale dhe standardizimit të procedurave inspektuese;
- Duke shkëmbyer përvoja mbi mënyrën e komunikimit me publikun me qëllim garantimin e parimit të transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave personale e integritetit të magjistratëve;
- Duke fuqizuar njohuritë, eksperiencën dhe kapacitetet e pjesëmarrësve, nëpërmjet organizimit të vizitave studimore dhe atyre të punës, takimeve në çështjet e interesit të përbashkët ose veprimtarive të përbashkëta trajnuese.

Neni 3

Forma e bashkëpunimit

Pjesëmarrësit ruajnë kontakte dhe marrëdhënie profesionale ndërmjet tyre, për të përditësuar eksperiencat dhe për të shkëmbyer informacione dhe të dhëna për legjislacionin e vendeve përkatëse, gjë e cila lidhet veçanërisht me shkëmbimin e teksteve të akteve ligjore dhe nënligjore, të materialeve analitike, statistikave dhe raporteve të inspektimeve.

Neni 4

Koordinimi ndërmjet pjesëmarrësve

1. Për të lehtësuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit sipas këtij Memorandumi Mirëkuptimi, pjesëmarrësit përcaktojnë personat e kontaktit dhe të gjitha komunikimet realizohen ndërmjet tyre, me përjashtim të rasteve kur është rënë dakord ndryshe.
2. Personat e kontaktit informojnë në vazhdimësi pjesëmarrësit, në lidhje me zbatimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi.
3. Komunikimi do të realizohet në formë shkresore ose nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik në adresat e mëposhtme:

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Godina nr.13, Tiranë, Shqipëri

Email: isida.koka@ild.al

Inspektoriati i Këshillit të Lartë Gjyqësor i Republikës së Bullgarisë

Adresa: Адрес: гр. София, ул. "Георг Вашингтон" №17

Email: ivss@inspectoratvss.bg

Neni 5

Shpenzimet

1. Në rastet kur përmbushja e kërkesave të këtij Memorandumi Mirëkuptimi shoqërohet me kosto financiare, pjesëmarrësit angazhohen për marrjen përsipër të tyre respektivisht, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm, brenda mundësive dhe fondeve buxhetore që kanë në dispozicion.
2. Pjesëmarrësit nuk duhet të kërkojnë rimbursim të shpenzimeve që dalin nga zbatimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi në rast se nuk specifikohet ndryshe në mënyrë të ndërsjelltë në secilin rast specifik.

Neni 6

Ndryshimet

Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të ndryshohet në çdo kohë me anë të pëlqimit të ndërsjelltë me shkrim të pjesëmarrësve. Çdo ndryshim i këtij Memorandumi Mirëkuptimi është i vlefshëm vetëm nëse bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga të dy pjesëmarrësit.

Neni 7

Heqje dorë nga përgjegjësia

Ky Memorandum Mirëkuptimi nuk krijon të drejta dhe detyrime për pjesëmarrësit sipas së drejtës publike ndërkombëtare, dhe as nuk ndikon në të drejtat dhe detyrimet që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë dhe Republika e Bullgarisë janë palë.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet apo paqartësitë që mund të lindin në kuadër të zbatimit të këtij Memorandumi Mirëkuptimi zgjidhen me mirëkuptim nga pjesëmarrësit.

Neni 9
Hyrja në fuqi

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të tij për një periudhë kohore të pacaktuar.
2. Secili prej pjesëmarrësve mund ta përfundojë këtë Memorandum Mirëkuptimi duke paraqitur një njoftim me shkrim për pjesëmarrësin tjetër. Në një rast të tillë, ky Memorandum Mirëkuptimi, pushon së qeni në fuqi, tre muaj pas datës në të cilën pjesëmarrësi tjetër ka marrë njoftimin për ndërprerjen e tij.

Neni 10
Gjuha dhe nënshkrimi

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi hartohet në gjuhën shqipe, bullgare dhe angleze dhe nënshkruhet në dy kopje identike në secilën gjuhë.
2. Në rastin e interpretimit të ndryshëm, mbizotëron teksti në gjuhën angleze.

Nënshkruar në Tirane, në datë 30.09. 2021.

Artur Metani

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë i
Republikës së Shqipërisë**



Toedora Tochkova

**Inspektor i Lartë i Inspektoriatit të
Këshillit të Lartë Gjyqësor të
Republikës së Bullgarisë**